



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SELENICË
KRYETARI

Shtojca 12

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT (PARAPRAK)

11.10.2024

Drejtuar: OE Boshnjaku B sh.p.k, me adresë: Lagjja Bishanake, Rruga Skenderbeu, Nr. 8, Pranë karbuantit "Bolv - Oil", Zona kadastrale nr 8532 Fier

Procedura e prokurimit/lotit: **E hapur, punë**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti, sasi dhe kohëzgjatja e kontratës]* **Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara, me nr. REF – 18250 – 09 – 09 – 2024, me kohëzgjatje 6 Muaj.**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **X**

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- OE INA SHPK**, me NIPT J61814009W, me ofertë: 40,323,357.29 (Dyzetë milion e treqind e njezet e tre mijë e treqind e pesëdhjetë e shtatë presje njëzet e nëntë) Lekë pa Tvsh dhe 48,388,028.75 (Dyzetë e tetë milion e treqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njezet e tetë presje shtatdhjetë e pesë) Lekë me Tvsh.
Operatori ekonomik INA SHPK skualifikohet në fazën e parë sipas shtojcës 8 të vetëdeklarimit.
- OE BOSHNJAKU. B sh.p.k** me NIPT: K72627402H, me ofertë: 45.566.004.36 (dyzetë e pesë million e pesëqind e gjashtë dhjetë e gjashtë mijë e katër presje tridhjetë e gjashtë) lekë pa Tvsh dhe 54.679.205,23 (pesëdhjetë e katër million e gjashtëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e pesë presje njëzetë e tre) Lekë me Tvsh
Operatori ekonomik Boshnjaku B kualifikohet në fazën e parë sipas shtojcës 8 të vetëdeklarimit.
- BOE "SARDO"** sh.p.k me Nipt: K13120402W me adresë: Lagjja Apollonia, Rruga Jakov Mile, Fier si dhe Oe LIQENI VII sh.p.k me Nipt: K01730502W, me adresë: Rruga "Dituria", Zona Kadastrale nr.8516, Nr.pasurie 10/268, Lagjja 14, Kodi Postar 2007, Shkoze Durrës me ofertë të përbashkët 45.732.540 (dyzetë e psë million e shtatëqindë e tridhjetë e dy mijë e pesëdhind e dyzetë) Lekë pa Tvsh dhe 54.879.048 (Pesëdhjetë e katër milion e tetëqindë e shatëdhjetë e nëntë mijë e dyzetë e tetë) Lekë me Tvsh.

Bashkimi Operatorëve ekonomik Sardo shpk dhe Liqeni VII sipas shtojcës 8 të vetëdeklarimit kualifikohet në fazën e parë.

4. **BOE C O L O M B O** sh.p.k me Nipt: J82916489E me adresë: Lagjja Kryengritja e Fierit, rruga Vangjel Rrushku, godina nr.67 Fier si dhe Oe Ndërtimi me Nipt: K11325002C me adresë: Rruga Gjergj Legisi Nr.7, Apartamenti Nr.2, Kodi 1025, Laprake, Tiranë me ofertë të përbashkët 46. 494.818 (dyzetë e gjashtë milion e katërqind e nëntëdhjetë e katër mijë e tetqind e tetëmbëdhjetë) Lekë pa Tvsh dhe 55 793 781 (pesëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e tre mij e shtatqind e tetëdhjetë e një) Lekë me Tvsh.
Bashkimi Operatorëve ekonomik C O L O M B O shpk dhe Ndërtimi shpk sipas shtojcës 8 të vetëdeklarimit kualifikohet në fazën e parë.
5. **OE B93 II** sh.p.k me Nipt: L52209050C me adresë: Rruga "Margarita Tutulani", pallati "Kaso", Tiranë me ofertë, 48.041.058,93 (dyzetë e tëtë milion e dyzetë e një mijë e pesëdhjetë e tetë presje nëntëdhjetë e tre) Lekë pa Tvsh dhe 57,649,270.72 (pesëdhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e dyzetë e nëntë mijë e dyqind e shtatëdhjetë pikë shtatëdhjetë e dy) Lekë me Tvsh.
Operatori ekonomik B93 II sipas vetëdeklarimit shtojca 8 kualifikohet në fazën e parë.
6. **BOE S P E K T R I** sh.p.k me Nipt: J62903555F me adresë: Lagjja 29 Nentori, Rruga Dervish Hekali, Pallati Nr 8, Fier si dhe Oe J O G I sh.p.k me Nipt: J63229478K me ofertë të përbashkët 50.155.288 (pesëdhjetë milion e njëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e dyqind e tetëdhjetë e tetë) Lekë pa Tvsh dhe 60 186 345 lekë (gjashtëdhjetë milion e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e dyzet e pesë) Lekë me Tvsh.
Bashkimi i operatorëve ekonomik Spektri shpk dhe operatori Jogi shpk sipas formularit të vetëdeklarimit shtojca 8 kualifikohen në fazën e parë.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. **OE INA SHPK**, me NIPT J61814009W, për arsyet e mëposhtme:

Komisioni vlerësimit të ofertave gjatë vlerësimit të ofertave kostatoj se subjekti INA me NIPT: J61814009Ë nuk plotëson kriteret e vecanta të kualifikimit si më poshtë: Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit subjekti INA shpk është mbështetur në kapacitetet e subjektit “BENAKS-94” me staf dy shofer z. Arben Mancellari dhe z. Almir Bako, por nuk ka paraqitur në SPE formularin shtojcës 8 të subjektit “BENAKS-94” ku është e nevojshme për AK për vërterësinë nëse subjekti në të cilën është mbështetur i plotëson kushtet për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit të deklaronte sipas shtojcës 8 formularit të vetëdeklarimit me informacionet e mëposhtme si vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Subjekti "BENAKS-94" me NIPT J73804663H ka marrë formularin e Vetëdeklarimit ku është në kundërshtim me ligjin Nr.162 /2020 "Për prokurimin publik" neni 82 neni 87 si dhe në kundërshtim me Vendimin Nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" neni 26 si dhe neni 39.

Subjekti "BENAKS - 94" me NIPT J73804663H ka bërë deklaratën e angazhimit në mbështetje të dy shoferave, ku thuhet se në cilësinë e subjektit në kapacitetet e të cilit do të mbështet operatorin ekonomik INA SHPK në përmbushjen e kriterëve të parashikuar të DST, me qëllim pjesëmarrjen në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë 27.09.2024 nga Autoriteti Kontraktor "Bashkia Selenicë" me objekt: "Mbikqyrje: Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara" me Nr. REF-21057-09-23-2024 ndërkohë procedura që zhvillohet nga autoriteti kontraktor ka për objekt "Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara" me Nr. REF-18250-09-09-2024 dhe jo objekt mbikqyrjen "Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara": REF-21057-09-23-2024 pasi ky objekt është në fazën e paraqitjes së ofertave, ku nuk ka përfunduar ende afati për paraqitjen e ofertave.

Stafi mbështetës nuk është paraqitur sipas formatit të kërkuar në DST sipas pikës 2.3.5 nga subjekti "BENAKS - 94"

Operatori ekonomik duhet të ketë të disponojë dokumentacionin që verteton profesionin si : Dëshmi profesionale të punonjësve ose ekuivalent të tij/saj, punonjësit e mëposhtëm me specialitetin figurojnë në listpagesat e shoqërisë.

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit të marrëdhënive të punës	Nr.Amzes/ekuivalent diplomes / certifikates profesionale	Institucioni/ Subjekti certifikues	Data e vlefshmërisë së certifikates profesionale
----	--------------	------------	------------------------------------------	----------------------------------------------------------	------------------------------------	--------------------------------------------------

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Nga ana e subjektit mungon shtojca 8 si dhe tabela përkatëse e fillimit të marrëdhënies së punës dhe data e vlefshmërisë së dokumentit ose certifikatës përkarësë. Ku është në kundërshtim me ligjin Nr.162 /2020 "Për prokurimin publik" neni 82 neni 87 si dhe në kundërshtim me Vendimin Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" neni 26 si dhe neni 39.

Subjekti INA shpk ka marrë pjesë në procedurën me objekt "Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara" ndërsa procedura për mbikqyrjen "Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara": REF-21057-09-23-2024 nuk ka përfunduar afati për paraqitjen e ofertave.

Në pikën 2.3.6 autoriteti kontraktor ka kërkuar në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivin përkatës, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontratë bashkëpunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/mallra në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë:

- Pajisje hidraulike;
- Pajisje elektrike;

Për rastin kur autorizimi do të jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin që verteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin (kontratë/autorizim). Operatori ekonomik të paraqesë katalogjet përkatëse për secilin nga produktet/mallrat e mësipërme. Gjithashtu O.E. të paraqesë deklaratë garancie jo më pak se 1 vit nga momenti i marrjes në dorëzim.

Subjekti INA shpk ka bërë autorizim distributor me shoqërinë “Sali Elektrik” në Datën: 27.09.2024 me objekt autorizimi Mbikqyrje “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara”: REF-21057-09-23-2024 dhe jo objektin që zhvillohet nga autoriteti kontraktor “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara” Nr. REF-18250-09-09-2024.

Po në datën: 27.09.2024 shoqëria “Abiesse shpk” prodhues i materialeve elektrike ka autorizuar shoqërinë INA shpk nëse shpallet fituese në procedurën e zhvilluar nga AK të furnizoj shoqërinë me material elektrike , me objekt Mbikqyrje “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara”: REF-21057-09-23-2024. Nuk është bërë autorizimi për objektin që zhvillohet nga AK.

Po në datën: 27.09.2024 shoqëria “Brunes shpk” ka autorizuar shoqërinë INA shpk të furnizohet me mallra hidrosanitare dhe pllaka po me të njëjtin objekt Mbikqyrje “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara”: REF-21057-09-23-2024. Nuk është bërë autorizimi për objektin që zhvillohet nga AK.

INA shpk është në kundërshtim me ligjin Nr.162 /2020 “Për prokurimin publik” neni 77 si dhe në kundërshtim me Vendimin Nr. 285 datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik neni 40 pika 6/c.

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur Ekstraktin e Kompanisë.

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur Listëpagesën e 3 muajve të fundit ku autoriteti e ka të nevojshëm për llogaritjen e numrit mesatar të punonjësve me 42 (dyzetë e dy) punonjës mesatarja në muaj.

Operatori ekonomik nuk ka deklaruar në shtojcën 8 rripa siguri dhe është në kundërshtim me VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **OE BOSHNJAKU. B sh.p.k.**, me adresë: Lagjja Bishanake, Rruga Skenderbeu, Nr. 8, Pranë karbuantit "Bolv - Oil", Zona kadastrale nr 8532 Fier, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 45.566.004.36 (dyzetë e pesë million e pesëqind e gjashtë dhjetë e gjashtë mijë e katër presje tridhjetë e gjashtë) lekë pa Tvsh dhe 54.679.205,23 (pesëdhjetë e katër million e gjashtëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e pesë presje njëzetë e tre) Lekë me Tvsh, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR